



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

---

**C.nr.630/16**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**, kryetari i kolegjit-gjyqtari Malsor Kryeziu, me gjyqtarët porot Xhavit Elezi dhe Ismet Këndusi dhe me pjesëmarrjen e sekretares juridike Drita Haxhishabani, në çështjen juridike të propozuesve F. S, nga Gjakova, dhe Q,D-S, nga Gjakova, për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor jo publik, me datë 10.01.2017, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. ZGJIDHET** martesë me shkurorëzim, e lidhur në mes të propozuesve F. S, i lindur me ... dhe Q. D.-S, e lindur ..., martesë kjo e lidhur me datë 01.08.2016, pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë, me numër të referencës 2/2016RM/2001 dhe me numër rendor 224.

**II.** Secila palë i mbartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Me propozimin e përbashkët të propozuesve F. S, nga Gjakova, dhe Q.D-S, nga Gjakova, të paraqitur në Gjykatën Themelore në Gjakovë, me dt.29.11.2016, është iniciuar procedura kontestimore për zgjidhjen e martesës me marrëveshje në mes të bashkëshortëve, këtu propozuesve.

Propozuesi në seancën kryesore ka deklaruar se qëndron në tërësi si në propozimin e paraqitur me shkrim në këtë gjykatë. Ne propozuesit kemi arritur marrëveshje që ta zgjidhim martesën me shkurorëzim meqenëse e njëjta e ka humbur kuptimin për shkak të botëkuptimeve të ndryshme, dhe nuk kemi gjetur gjuhë të përbashkët që ta vazhdojmë martesën. Në këtë martesë nuk ka fëmijë të lindur dhe as që pritet një gjë e tillë të ndodhë dhe për këtë arsye i ka propozuar gjykatës që të aprovohet propozimi i përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar: në tërësi si në propozimin e përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje si dhe deklarimin në seancën e sotme. I propozoj gjykatës që konform dispozitave Ligjore të Ligjit për Familjen të Republikës së Kosovës të merr aktgjykim dhe të zgjidhet martesë me shkurorëzim. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

Propozuesja në seancën kryesore ka deklaruar se qëndroj në tërësi si në propozimin e përbashkët për prishjen e martesës me marrëveshje. Konsideroi se janë plotësuar të gjitha kushtet për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, andaj i propozoj gjykatës që ta zgjidh martesën me aktgjykim. Ndërsa në fjalën e fundit ka deklaruar: mbetëm në tërësi si në propozimin e përbashkët dhe deklarimet në këtë seancë. Meqenëse janë plotësuar të gjitha kushtet që kjo martesë të zgjidhet me marrëveshje, i propozoj gjykatës që të aprovohet propozimi i përbashkët dhe të zgjidhet martesë. Shpenzimet nuk i kërkoi.

Gjykata në kuptim të nenit 84 par. 1 të Ligjit për Familjen i Kosovës, nuk i hetoi faktet në të cilat është mbështetur propozimi i përbashkët i bashkëshortëve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, pasi që vlerëson se nga theksimet e palëve gjatë zhvillimit të seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes, këto fakte janë të pakontestueshme.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të çështjes gjykata administroi si provë Certifikatën e Martesës me numër serik M 10194343, e dt.01.08.2016, me nr. të referencës 2/2016RM/2001 dhe me numër rendor 224, martesë kjo e lidhur në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, me të cilën provë u vërtetua ekzistimi i martesës në mes bashkëshortëve dhe atë e lidhur që nga data 01.08.2016.

Gjykata pas shqyrtimit kryesor të çështjes dhe dëgjimit të theksimeve të propozuesve, gjatë seancës kryesore dhe në propozimin e përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, vendosi që në kuptim të nenit 68 par.1 të Ligjit për Familjen i Kosovës, të aprovon këtë propozim dhe të zgjidh martesën mes propozuesve pasi që konstatoi se vullneti i shprehur për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, në propozimin e paraqitur, është i lirë serioz dhe pa ndikime.

Vendimi mbi shpenzimet e kësaj procedure është marr në kuptim të nenit 463.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**C.nr.630/16, me datë 10.01.2017**

**Gjyqtari**  
**Malsor Kryeziu**

**UDHËZIME PËR ANKESË:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, dhe atë nëpërmjet kësaj gjykate.